



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1447/5 prot.

Datë 12.06.2024

V E N D I M
Nr. 673/2024

Fiorent Zguro
Gjergj Mersini
Anila Malaj

Nënkryetar
Anëtar
Anëtar

Në mbledhjen e datw 12.06.2024 me:

- Objekt:** Vendim për mbylljen e çështjes lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-07663-05-31-2024, me objekt: “*Loti II Blerje materiale të ndryshme për pastrim*”, me fond limit 6,417,084.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve te Perqendruara.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK me NIPT K21605003M dhe adresë: Autostrada Tirane-Durres, Rruga Dytesore Km 9, Godine 3 kateshe
- Autoriteti Kontraktor:** Operatori i Blerjeve te Perqendruara Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nr.3 , Tiranë”.
- Baza Ligjore:** Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “*Për prokurimin publik*”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”. Nenet 4, te Vendimit te Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraparak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nënit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 03.06.2024 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-07663-05-31-2024, me objekt: “Loti II Blerje materiale të ndryshme për pastrim”, me fond limit 6,417,084.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Pergendruara.

II.2. Në datën 05.06.2024 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1447/2024 protokollit, datë 05.06.2024 dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4165, e operatorit ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK, me anë të së cilës kërkohet modifikimi i dokumenteve të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.3. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe ankesën e plotë të ankimuesit.

II.4 Nëpërmjet shkresës ardhur në sistem nr. 436/10 prot., datë 07.06.2024 , protokolluar me tonën me nr. 1447/2 prot., datë 12.6.2024 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “INTERLOGISTIC” SHPK. Referuar Vendimit të KSHA rezulton Nr. 436/8 datw 07.06.2024 se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës.

Komisioni i Prokurimit Publik, pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e ankimuesit mbi modifikimin e dokumenteve të procedurës së prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Njëpërmjet shkresës nr. 436/10 prot., datë 07.06.2024 , protokolluar me tonën me nr. 1447/2 prot., datë 12.6.2024 është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik Vendimi i Komisionit për shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik ankimues "INTERLOGISTIC" SHPK. Referuar Vendimit të KSHA rezulton Nr. 436/8 datw 07.06.2024 rezulton , se ky i fundit ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues dhe ka vendosur pranimin plotësisht të ankesës, me arsyetimin se: [...] Komisioni i shqyrtimit të ankesës, referuar pretendimit të ankimuesit dhe në mbështetje të Ligit 162/2021 "Për prokurimin publik" i ndryshuar, Neni 2 "Qillimi i ligjit", geramat c), s), d), Neni 21 "Autoriteti ose enti kontraktor" , pika 1, me gëllim nxitjen e pjesëmarrjes së operatoreve ekonomike në këtë procedurë prokurimi, nxitjen e konkurrencës ndërmjet operatoreve ekonomike për këtë procedurë prokurimi, sigurimin e një trajtimi të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës, gjykon, se afati i levrimit i përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi nuk është i mjaftueshëm për realizimin në kohë dhe me çilesi të objektit të prokurimit, duke pasur parasysh sasine e konsiderueshme të mallit që do të levrohet, tipin dhe volumin e kontratës si dhe shpërndarjes së mallit, Ndaj KSHA gjykon, se afati i levrimit të mallit në rastin konkret duhet të jetë me i gjatë në përputhje me volumin dhe përmasat e kontratës, në mënyrë që ofertuesve t'ju lihet koha e nevojshme për të siguruar në kohë mallin me karakteristikat dhe specifikimet e kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

Për riedhoje KSHA gjykon se pretendimet e ankimuesit lidhur me afatet e levrimit gëndrone dhe behen ndryshimet si më poshte: **Ishte:** Afatet e levrimit: 10 (dhjete) dite nga nënshkrimi i kontratës. **Behet:** Afatet e levrimit: 30 (tridhjetë) dite nga nënshkrimi i kontratës.

PER KETO ARSYE Bazuar në nenin 114 ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, dhe nenin 102 të VKM-së nr.285 datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", indryshuar, zyrtarët e ngarkuar për shqyrtimin e ankesës, VENDOSËN

1. Pranimin e plote të ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik "INTERLOGISTIC" shpk
2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.
3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.
4. Ky vendim i njoftohet menjëherë Titullarit të Organit Qëndror Blerës.[...]

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrtton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera.

III.1.3. Neni 114 e ligjit 162/2020 "Për Prokurimin Publik" i cili parashikon shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatoreve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

- a) pranimin e plotë të ankesës;*
- b) pranimin e pjesshëm të ankesës;*
- c) refuzimin e ankesës.*

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.1.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.1.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 1447/2 prot., datë 12.06.2024 KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Operatori i Blerjeve te Perqendruara ka pranuar plotësisht ankesën e operatorit ekonomik ankimues “INTERLOGISTIC” SHPK, për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

Në këto kushte, bazuar në pikën 3 të nenit 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.236, datë 20.04.2024 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimim në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK,, për procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar”, me REF-07663-05-31-2024, me objekt: “Loti II Blerje materiale të ndryshme për pastrim”, me fond limit 6,417,084.00 lekë pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar në datën 13-06-2024 nga autoriteti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Perqendruara.
 2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet e DST sipas konstatimeve të KSHA për procedurën e mësipërme të prokurimit.
 3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e këtij vendimi.
 4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “INTERLOGISTIC” SHPK
 5. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

